



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:105167

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05453603

P.nr.593/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Gani Kastrati, me bashkëpunëtoren profesionale Rona Myftiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit E. (C.) A., nga Prizreni, me banim në rr “.....” nr., për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 330 par. 1 të KPRK-së (04/L-082), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.646-13/19 të datës 15.05.2019, jashtë seancës gjyqësore, me datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.646-13/19 të datës 15.05.2019.
- II. **PUSHOHET** procedura penale ndaj të akuzuarit E. (C.) A., nga Prizreni, për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 330 par. 1 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut (**ndalesa absolute e ndjekjes penale**).

E dëmtuara “.....” sh.p.k me seli në fshati Pestovë, e përfaqësuar nga av F.S., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 05.02.2018 pranë kësaj Gjykate e ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.646-13/19 të datës 15.05.2019, kundër të akuzuarit E. (C.) A., nga Prizreni, për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1 të KPRK-së (04/L-082).

Pas pranimi të lëndës, gjyqtari i çështjes ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 11.09 në këtë seancë është propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës alternative – ndërmjetësimit, i cili propozim me aktvendim është miratuar nga gjyqtari i çështjes. Në procedurën e ndërmjetësimit, i akuzuari ka deklaruar se nuk ka mundësi financiare që të bëjë pagesën e dëmit të shkaktuar nga ana e tij të dëmtuarës “.....” sh.p.k, ashtu që lënda ka mbetur ende e pashqyrtuar. Mirëpo në muajin janar 2024, kjo lëndë është ndarë tek gjyqtari

G.K., , ndërsa gjyqtari pas shikimit të shkresave të lëndës ka arritur në përfundim se për këtë çështje penale ka arritur parashkrimi i ndjekjes së veprës penale.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 330 par. 1 të KPRK-së, ku parashihet: *“1. Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personit tjetër, e përvetëson pasurinë e cila i është besuar atij apo personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.”*

Nga shkresat e lëndës, gjyqtari gjykues konstatoi se vepra penale Asgjësimi nga neni 333 par.1 të KPRK-së (04/L-082), është kryer me datë 01.02.2019 dhe për këtë veprë penale është i paraparë dënimi me burg deri në 1 (një) vit dhe është konstatuar se për këtë veprë penale ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale, bazuar në nenin 106 par. 1, nën par. 1.6 të KPRK-së, ku parashihet që ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 2 (dy) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në 1 (një) vjet burgim, ndërsa bazuar në nenin 107 par. 8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), gjegjësisht 4 (katër) vite, kurse në rastin konkret kanë kaluar më shumë se 5 (pesë) vite nga koha e kryerjes së veprës penale (01.02.2019) nga ana e të akuzuarit dhe ka arritur parashkrimi - ndalesa absolute e ndjekjes penale.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata e mori në kuptim të dispozitës së nenit 462 par. 3 të KPPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në kuptim dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 357 par. 1, nën par. 1.3 të KPPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.593/19 të datës 14.03.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gani Kastrati

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa, në afat prej 3 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.